

Data 05/10/2022

**PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - SHËRBIME**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “MONITORIMI GJEODEZIK I DIGAVE TË KASKADËS SË LUMIT DRIN DHE MASIVËVE TË PAQENDRUESHËM GJEOLGJIK PRANË TYRE”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Shërbime të ndryshme - **98300000-6** .

**VLERA E FONDIT LIMIT: 6,900,000** (Gjashtë milion e nëntëqind mijë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor **Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 5;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 12.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

*Sipas Shtojcës 12.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se se 40 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedures është "Shërbim Konsulence", përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, gërma "c" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku përcaktohet se: " 40% të vlerës së parashikuar të kontratës në procedurat e prokurimit..... dhe ne procedurat e prokurimit "Shërbim Konsulence" si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 1 " të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".*

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

***Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:***

- a) *Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

**2.3.2** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Licencë profesionale të vlefshme të shoqërisë për projektim (lëshuar nga MIE ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), sipas përcaktimit në vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”, ku të përfshihen kategoritë si me poshtë:

✚ **PROJEKTUES GJEODET Kat 8** a) Rilevime inxhinerike; c) Sisteme GIS; d) Bazamente Gjeodezike; e) Projektim fotogrametrik dhe hartografik.

✚ **STUDIME GJEOLIGO INHINIERIK – HIDROGJEOLOGJIK Kat 9** c) Studim/ Vlersim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte të mëdha H/C, porte, aeroporte, bazamente me ngarkesa të mëdha.

**Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme në projektim, sipas formatit të miratuar me VKM nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, të lëshuar nga institucionet e autorizuara me ligj.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016 (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që

*parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Pikat e licensës së kërkuar janë bazuar në shërbimin i cili kërkohet të sigurohet sipas detyrës së projektimit të përgatitur nga specialistët e fushës.

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues, duhet të ketë në stafin e tij për periudhën Korrik 2022 – Gusht 2022 inxhinierët e mëposhtëm:

- ✚ 1 (një) Inxhinier Gjeodet, në pozicionin e drejtuesit teknik me eksperience jo me pak se 10 vite dhe i paisur me licencën përkatëse 8/a,d.
- ✚ 1 (një) Inxhinier Gjeolog me orientim Hidrogeologji, në pozicionin e drejtuesit teknik me eksperiencë jo me pak se 10 vite dhe i paisur me licencën përkatëse 9/c.
- ✚ 2 (dy) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik me eksperiencë jo me pak se 3 vjet.

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë AK dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:**

Kontratë punë e vlefshme, diplomë, CV (si dhe licencat profesionale për projektim, sipas **VKM nr. 943, datë 28.12.2016)**

*Shënim: Për efekt të vlerësimit me pikë operatorët mund të ngarkojnë në fazën e parë ose të dytë dokumentacionin e kërkuar lidhur me pikën e mësipërme.*

**\*Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

- ✚ 1 (një) Inxhinier gjeodet, në pozicionin e drejtuesit teknik me eksperience jo me pak se 10 vite dhe i paisur me licencën përkatëse 8/a,d.
- ✚ 2 (dy) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder/Gjeomatik me eksperiencë jo me pak se 3 vjet

Këta inxhinier kërkohen bazuar në detyrën e projektimit ku kërkohet monitorimi gjeodezik i digave dhe masivëve të paqëndrueshën. Sipas detyrës së projektimit kryerja e matjeve gjeodezike duhet të jetë me saktësi të lartë në të gjitha pikat e referimit, të nivelacionit si dhe në monumentet gjeodezike të rrjetit të monitorimit gjeodezik i cili gjendet në terren.

Drejtuesi teknik është kërkuar të jetë i paisur me licencën përkatëse 8/a,d, referuar shërbimit i cili kërkohet të kryhet ku përfshihen Kat 8/a rievime inxhinierike dhe Kat 8/d bazamente gjeodezike. Kërkesa e mësipërme është në përputhje të plotë me detyrën e projektimit.

✚ 1 (një) Inxhinier Gjeolog me orientim Hidrogjeologji, në pozicionin e drejtuesit teknik me eksperience jo më pak se 10 vite dhe i pajsur me licencën përkatëse 9/c.

Ky inxhinier kërkohet bazuar në detyrën e projektimit ku kërkohet të kryhet monitorimi gjeodezik i digave dhe masivëve të paqëndrueshëm. Kategoria përkatëse e kërkuar 9/c vlerësim gjeolog – inxhinierik i truallit për objektet e mëdha H/C.....

Kërkohet për studimin e kushteve gjeologjike nëntokesore dhe hidrogjeologjike në zonën ku do të kryhet monitorimi gjeodezik, në rrjedhat e sipërme dhe rrjedhat e poshtme të vendmonitorimeve të përcaktuara në detyrën e projektimit.

Për sa i takon viteve të eksperiencës së punës të përcaktuar në këtë kriter ku kërkohet, për drejtuesit teknik të kenë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet eksperiencë dhe për stafin mbështetës jo më pak se 3 (tre) vjet eksperiencë argumentojmë se, kjo eksperiencë është kërkuar bazuar në rendësinë e kryerjes së këtij shërbimi i cili është detyrim për AK-në, bazuar në Ligjin 8681, datë 02.11.2000 dhe VKM Nr.147, datë 18.03.2004 ku përfshihen kryerjen e monitorimit gjeodezik në Digat e kaskadës së lumit Drin si dhe masivëve të paqëndrueshëm gjeologjik pranë tyre si dhe përpunimin dhe e të dhënave të matjeve të kryera dhe krahasimi i tyre me leximin fillestar. Gjithashtu vitet e punës janë kërkuar bazuar në llojin e procedurës dhe vlerësimit me pikë të përcaktuar në DT.

*(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar shërbimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe nëse është rasti, për llojin e licencës/ certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).*

**2.3.4** Operatori ekonomik ofertues, duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 10 (dhjetë) punonjës, për periudhën Korrik 2022 – Gusht 2022.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetë deklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë AK dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:**

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Qershor 2022- Gusht 2022.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kërkuar argumentojmë se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Detyrës së Projektimit, siç janë: Kryerja e matjeve për monitorimet gjeodezike në pikat e përcaktuara në Detyrën e Projektimit e cila do të kryhet me mjetet e nevojshme të kërkuara (total station, Pajisje lazer - skanner 3D) dhe pas kryerjes të matjeve duhet të bëhet e mundur përgatitja dhe përpunimi i të dhënave. Të gjitha këto procese punë duhet të kryhen nga specialistë të fushës përkatëse.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje Korrik 2022- Gusht 2022, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ISO ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- b) ISO 14001:2015 “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”;
- c) ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”

***Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë çertifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.***

***ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”*** - Ky standard është i nevojshëm për certifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse shërbimet e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

***ISO 14001-2015 “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”*** – Ky është e nevojshme që Kontraktori të ketë staf të vetëdijshëm për politiken mjedisore dhe pasojat e mundshme të aktiviteteve të tyre në mjedis. Aktivitetet e kontraktorit duhet të jenë të tilla që të kontrollohet ndikimi në mjedis dhe të përgjigjet në rast emergjence të ndikimit në mjedis.

**ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”**- Ky standart është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlerësimin e rrisqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

**Argumentimi:** *Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*

*Çertifikatat e cilësisë janë bazuar në përputhje me objektin e shërbimit që do kryhet dhe janë në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.*

**2.3.6** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- ✚ 1 (një) Pajisje Total Station;
- ✚ 1 (një) Pajisje Laser-Skanner 3 D;
- ✚ 2 (dy) Automjet, në pronësi ose me qira.

*Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike operatori duhet të paraqesë:*

**a)** *Për pajisjet operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij si psh. **Faturë tatimore të shitblerjes ose kontrate qiraje të noterizuar.** Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e mjetit. Kur janë në pronësi të paraqitet certifikata e pronësisë, leja e qarkullimit siguracioni i automjetit, certifikata e kontrollit teknik.*

**b)** *Për mjetet e siguruara me qira, dokumentat e mësipërm duhet të shoqërohen edhe me kontratën përkatëse noteriale të qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*

**Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë AK dokumentacionin e mësipërm i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit.**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet paraqesë me anë të një deklaratë listën e personelit kryesor të nevojshëm që do të realizojë objektin e kontratës si dhe CV të shoqërisë për shërbimet e realizuara gjatë aktivitetit të saj.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur referuar nenit 41, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë eksperiencën e konsulentit në projekte të ngjashme për shërbimet e realizuara gjatë aktivitetit të saj.

**Në rastet e bashkimit të konsulentëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

## **Njësia e Prokurimit**